

VENDIM
Nr. 364, datë 15.12.2023

MBI MIRATIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI, PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 10 dhe 31, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe neneve 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 930/36 prot., datë 13.12.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2024”,

konstatoi se:

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, më datë 23 mars 2023, ka miratuar ligjin e ri nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 7/2017. Në nenin 10, pika 4, përcaktohet se: “Për prodhues ekzistues me përparësi, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 mw caktohet nga ERE në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit”. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, plus një bonus të caktuar për promovimin e këtyre burimeve, i cili merr në konsideratë një kthim të arsyeshëm të vlerës së investimeve. Në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE në vitin 2016”.

- Gjithashtu, në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji përcaktohet se aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji (ligjit nr. 24/2023).

- Me vendim të Këshillit Ministrave 687/2017, të ndryshuar, është miratuar metodologjia e përcaktimit të “Çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, ku ky çmim përllogaritet sipas formulës si vijon : çmimi vjetori i blerjes (lekë/kwh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kwh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.2 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit”.

- Nga të dhënat paraprake nga faqja e internetit të Bursës Hungareze të Energjisë (<https://hupx.hu/en/market-data/dam/regular-reports>), është marrë çmimi i deritanishëm mesatar për periudhën 11-mujore të tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) për vitin 2023, i cili rezulton në vlerën 109.39 euro/mwh.

- Sipas metodologjisë, me normë mesatare të shkëmbimit të vitit të fundit, kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2023. Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit, rezulton se kursi mesatar i këmbimit për 11 muajt, tashmë të mbyllur të vitit 2023 (janar–nëntor), rezulton të jetë 108.84 lekë/euro.

- Nga të dhënat paraprake rezulton se çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike do të jetë 14.29 lekë/kwh. Në zbatim të VKM-së nr. 687/2017, të ndryshuar, ky çmim rezulton të jetë mbi nivelin maksimal të çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike të përcaktuar në germën “d”, prej 10

lekë/kwh. Për rrjedhojë, çmimi i blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2024 do të jetë ai prej 10 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi prej 10 lekë/kwh, për vitin 2024.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti